

MBROJTËSI

Vëllimi IV - Nr. 5

www.kosovopolice.com
info@kosovopolice.com



NJME

ATY KU GABIMI MË I VOGËL KUSHTON ME JETË

Njësiti për Mbrojtje nga Eksplozivët i Policisë së Kosovës, njësia më e kompletuar në rajon



Arbër Beka

Motivi dhe beneficionet

Cdo shkrim i publikuar në këtë revistë për ndonjë lëvizje eventuale pozitive në sistem të pagave të punonjësve të PK-së ka qenë i lexuar me kujdes nga zyrtarët policor. Ndoshta pse tema të tilla kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë ndër “temat e nxehta” të diskutimit të pjesëtarëve të PK-së.

Grupi punues që ishte formuar për krijimin e një sistemi të ri të pagave në PK kishte vërejtur se sistemi aktual i pagave nuk merr për bazë shtesat për punët dhe veprimtaritë e policisë të cilat janë specifike vetëm për personelin policor, prandaj ata kanë konsideruar se me një sistem të ri të pagave mund të përmirësohej sadopak mirëqenia e zyrtarëve por që kjo do të ndikonte pozitivisht edhe në ngritjen e motivit në punë. I tërë aktiviteti i këtij grupi punues (lidhur me shtesat dhe beneficionet) ishte i mbështetur në atë që tanimë ishte edhe në Ligjin për Policinë të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ky sistem i pagave do të ndihmojë në rrugëtimin tonë të përbashkët në ndërtimin e një policie efektive dhe efikase, të pakorruptuar dhe profesionale që është në shërbim të të gjithë qytetarëve kosovar. Nëse i grumbullojmë të gjitha këto në një vend na del një pjesë e “formulës” së funksionimit të një shteti ligjor, e funksionimi ashtu si duhet i shtetit ligjor (që është një sferë shumë më e gjerë se këto që u cekën) hap rrugën drejt integriteteve evropiane për shtetin më të ri në botë, me institucione të qëndrueshme dhe të afta për t’ju dalë ballë sfidave të ndryshme që paraqiten kohë pas kohe.

Personalisht kam qenë i kënaqur për marrëveshjen që u arrit (në momentin e fundit para protestës

së paralajmëruar) në mes Sindikatës së PK-së dhe Qeverisë. Shpresoj se ky është hapi i parë e që do të pasojnë edhe marrëveshje të tjera ose më mirë të them vendime të tjera që do të merren nga institucionet kyçe vendore në drejtim të përmirësimit të mirëqenies së pjesëtarëve të PK-së (përfshirë këtu edhe stafin civil).

Një prej temave në këtë numër të Mbrojtësit trajton pikërisht sistemin e ri të pagave dhe tregon për angazhimet e grupit punues për këtë sistem nga MPB-ja dhe PK-ja.

Një prej shtesave që pritet të paguhet që nga janari i 2009-ës është edhe ajo e rrezikshmërisë. Duke u ndërlidhur me termin “rrezikshmëri” mund të lexoni për aktivitetet e Njësitit për Mbrojtje nga Eksplozivët – NJME-në, si njësi profesionale dhe e trajnuar mirë për specifikat që përfshihen gjatë kryerjes së detyrave nga NJME-ja.

Në një prej shkrimeve ju do të lexoni edhe për misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovës –EULEX, që është misioni më i madh civil i ndërmarrë bazuar në Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP). Synimi kryesor i misionit është mbështetja e autoriteteve të Kosovës përmes monitorimit, përkujdesjes dhe këshillimit në të gjitha fushat që lidhen me sundimin e ligjit, në veçanti me policinë, drejtësinë dhe doganat. Komponenti i Policisë në EULEX është pjesë e mbështetjes së përgjithshme të këtij misioni për autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. Ky mision do të ndihmojë Policinë e Kosovës për të punuar në drejtim të policisë shumë-etnike, që është e lirë nga ndërhyrjet politike dhe që i shërben popullit të Kosovës.



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i PK-së dhe policisë së UNMIK-ut.

Botues

Njësitë i Redaksisë,
Zyra e Komisarit për Media,
SHP i Policisë, Prishtinë

Redaktor

Arbër Beka
VSAT: 2699
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 146 696
arber.beka@kosovopolicice.com
arberbeka@gmail.com
revistambrojttesi@kosovopolicice.com

Fotograf

SERHAT ALKAN
VSAT: 2323
Mob.: 044 416 106

Disajner

Çajup Kajtazi
Bashkim Përçuku
VSAT: 1046/1145
Mob.: 049 847 072
049 300 005
çajup.kajtazi@kosovopolicice.com
bashkim.përçuku@kosovopolicice.com

Asistentët e Redaktorit

Drin Gjonbalaj
Renata Marijanac
Tamara Mashiq



VËLLIMI IV-të, Nr. 5

MBROJTËSI TETOR 2008

2 PARLAMENTI EVROPIAN

Siguria e një vendi –
çelësi i zhvillimit ekonomik

3 MIGRIMI

Trajtimi juridiko - Kushtetues i të drejtës
së migracionit

5 SISTEMI I RI I PAGAVE NË PK

Sistemi i ri i pagave dhe i shtesave në Polici-
në e Kosovës sistem në favor të përmirësimit
të mirëqenies së personelit policor

8 SIGURIA E FËMIJËVE

“Siguria në rrugë - Shtator 2008”
fushatë për sigurinë e fëmijëve

11 NJME

Aty ku gabimi më i vogël
kushton më jetë

14 NËNTË VJETORI I PK-së

Policia e Kosovës pas nëntë viteve
Themel i rëndësishëm i së ardhmes
së Kosovës

16 QKSPEZH

Trajnime cilësore
dhe profesionale

18 LUFTA KUNDËR KRIMIT

Së bashku në luftën kundër krimit të organizuar

20 EULEX

Mbështetje për Policinë e Kosovës

23 NË LINJË TË DETYRËS

Ata nuk harrohen kurrë

25 FOTOLAJME

MË GJERËSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të UNMIK-ut dhe PK-së



SIGURIA E NJË VENDI – ÇELËSI I ZHVILLIMIT EKONOMIK

Një delegacion nga Parlamenti Evropian vizituan Policinë e Kosovës

Komiteti për Siguri dhe Mbrojtje në Parlamentin Evropian së bashku me Komisionin për Punë të Jashtme kanë organizuar një vizitë në Kosovë për t'u informuar më shumë rreth çështjeve të sigurisë dhe drejtësisë.

Në vazhden e kësaj, në tetor të këtij viti, pjesëtarë të këtij delegacioni të Parlamentit Evropian vizituan Policinë e Kosovës.

Këta pjesëtarë të Parlamentit Evropian u pritën nga Gjeneral Nënkolonel Sheremet Ahmeti me

bashkëpunëtorë i cili duke ju uruar mirëseardhje, gjatë takimit u dha atyre një përmbledhje lidhur me historikun e Policisë së Kosovës dhe sfidave që ka kaluar PK-ja gjatë këtyre nëntë viteve:

"Kemi pasur sfida të ndryshme gjatë këtyre nëntë viteve por me sukses ne i kemi tejkaluar ato dhe tani Policia e Kosovës është një ndër institucionet më të besueshme në Kosovë" – theksoi Gjeneral nënkolonel Ahmeti.

Ai tutje ceku edhe disa nga sfidat që janë akoma aktuale për PK-në si

bartja e plotë e kompetencave nga Policia e UNMIK-ut, krijimi i partneritetit me misionin e BE-së për sundimin e ligjit – EULEX-in, integrimi i PK-së në strukturat ndërkombëtare policore si Interpoli, Evropoli etj.

Gjatë takimit ky delegacion u njoftua edhe për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Republikën e Kosovës që konsiderohet si e qetë dhe stabile.

Delegacioni nga Parlamenti Evropian shprehu kënaqësinë për të arriturat që janë bërë në Policinë e Kosovës duke e cilësuar sigurinë e një vendi si çelësin e zhvillimit ekonomik:

"Ne jemi të bindur se puna është duke e bërë Policia e Kosovës është shumë e rëndësishme për Kosovën sepse siguria është çelësi i zhvillimit ekonomik të secilit vend" – theksoi para gazetarëve z.Karl von Wogau, pjesëtar i delegacionit të Parlamentit Evropian që e vizituan PK-në.



TRAJTIMI JURIDIKO - KUSHTETUES I TË DREJTËS SË MIGRACIONIT



*Nga major Refki Morina
Magjistër i shkencave
juridike-administrative*

MIGRIMI

Migrimi është një fenomen mbarë botërorë duke treguar një strukturë të qartë të njerëzve që lëvizin nga vende më pak të zhvilluara (kryesisht Jugu dhe Lindja) drejt vendeve më të industrializuara në Perëndim dhe në Veri. Si pjesë e këtyre vërshimeve të migrimit shumë njerëz largohen nga lufta, shtypja, shkatërrimi social, persekutimi dhe shkelja e rëndë e të

drejtave të njeriut dhe mbërrijnë ose kalojnë transit përmes Evropës Qendrore dhe kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Njerëzit që largohen nga vendet e tyre të Lindjes nga frika e persekutimit i bashkohen një rrjedhjeje më të madhe migrantësh të cilët largohen në kërkim të mundësive për punë, arsim, ribashkim me pjesëtarë të familjes ose për shkaqe të tjera.

Është vlerësuar që në fund të shekullit XX-të rreth 150 milion njerëz

jetonin jashtë vendit të tyre të lindjes një shumë prej rreth 2.5 % e popullsisë së botës ose një në 40 njerëz, prej këtyre rreth 15 milion ose 10% janë refugjatë. Në fillim të viteve të 90-ta, në tranzicionin e tyre në demokraci, vendet e Evropës Qendrore ratifikuan Konventën e Gjenevës të vitit 1951 dhe filluan të zhvillojnë sistemet e tyre kombëtare për të mbrojtur refugjatët.

Këto sisteme janë fokusuar më shumë në aspektin ligjor të regjimit të mbrojtjes ndërkombëtare ndërsa kanë nënvlerësuar rëndësinë e aspekteve të tjera të mbrojtjes duke përfshirë fushën e mbështetjes sociale.

Në mënyrë që të ofrohet mbrojtje efektive duke reflektuar standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian, është e rëndësishme të përgatisim punonjës social kompetent duke siguruar mundësin e hyrjes së tyre në programe të specializuara të arsimimit të lartë për këtë çështje.

Dallimet në mes azil-kërkuesit dhe refugjatit

Dallimi në mes të azil kërkuesit dhe refugjatit është pasi që fjala “ azil-kërkues ” është fjalë e përgjithshme për një person i cili ende nuk ka marrë vendimin rreth kërkesës së tij/saj, për statusin e refugjatit. Mund ti referohet ndonjërit që ende nuk e ka bërë kërkesën apo dikujt që është duke pritur përgjigje rreth kërkesës për status të refugjatit. Në fund, shumica e azil-kërkuesve do të njihen si refugjatë por jo të gjithë. Në lidhje me këtë shtrohet pyetja: Kush është refugjatë? Në bazë të Konventës për rregullimin e Statusit të Refugjatit në vitin (1951), azil-kërkues është çdo person që :

- Ka frikë të bazuar nga përndjekjet për shkak të përkatësisë së tij/saj
- përkatësisë racore
- përkatësisë fetare
- përkatësisë kombëtare
- pjesëmarrjes në ndonjë grup, shoqëri apo
- opinionit politik:
- është jashtë shtetit të origjinës dhe nuk është në gjendje apo
- nuk dëshiron të jetë i mbrojtur apo të kthehet në shtetin e origjinës për shkak të frikës nga persekutimi.

Edhe Kosova mundëson hyrjen në territor të azil-kërkuesve, kushtet e pritjes, efikasitetin dhe drejtësinë procedurale të vendosjes së azil-kërkuesve, zgjedhja e qëndrueshme duke u bazuar në të drejtat e Statusit të Refugjatit-në bazë të Konventës për rregullimin e Statusit të Refugjatit-1951.

Praktikat Ndërkombëtare të Migrimit

Parimi i gjithë punës me refugjatët është mbrojtja ndërkombëtare. Shumë shpesh koncepti i mbrojtjes ndërkombëtare perceptohet si të qenit i kufizuar në procedura ligjore dhe administrative, pasaportave dhe dokumenteve. Vendorsja e statusit të refugjatit dhe dokumentimi janë më parësoret. Mbrojtja ndërkombëtare, shkon larg kufijve të procedurave dhe letrave dhe kërkon një gam të tërë masash proaktive, të cilat synojnë të lehtësojnë që gratë dhe burrat me të cilët kemi të bëjmë mund të hyjnë (përfitojnë) ndaj shërbimeve sociale, ligjore të hartuara mirë dhe programeve të ndihmës. Masa të tilla të ofruara në një skemë të plotë dhe profesionale do ti ndihmojnë refugjatët për të gëzuar plotësisht të drejtat e tyre njerëzore dhe të bëhen të aftë për të marrë një rol aktiv gjatë integritimit në vendin e azilit, të kthimit në vendin e origjinës sapo t'ia lejojnë rrethanat ose kur të rifillojnë jetën në vendin e tretë. Në më shumë se pesëdhjetë vjet eksperiencë të mbrojtjes ndërkombëtare janë nxjerrë shumë mësimë. Shumë prej tyre i referohen nevojës për të identifikuar nevojat shpesh të ndryshme, mundësit dhe mjetet që njerëzit e grupe të ndryshme njerëzish kanë dhe duhet të kenë parasysh analizat e projektimit dhe ofrimit të strategjive profesionale në punën me refugjatë.

Në këtë proces institucional të të mësuarit theksi është vënë mbi tiparet lidhur me gjininë, moshën dhe nevojat për të analizuar sistematikisht ndikimet që kanë të bëjnë me hyrjen dhe mundësit e grave, burrave, vajzave dhe djemve për të gëzuar në mënyrë të gjithanshme të drejtat e tyre njerëzore. U qartësuan gjithashtu se ekzistojnë lidhje të pastra midis shkallës së përfshirjes, pjesëmarrjes së refugjatëve dhe aftësive për të lehtësuar zgjedhjet afatgjate për problemet e tyre dhe për të krijuar një ambient i cili e respekton dinjitetin e tyre njerëzor.



Pamje nga Këshilli Organizativ i Protestës

SISTEMI I RI I PAGAVE DHE I SHITESAVE NË POLICINË E KOSOVËS

sistem në favor të përmirësimit të mirëqenies së personelit policor

Arrihet marrëveshja në mes Sindikatës së PK-së dhe Qeverisë – anulohet protesta

Kohë më parë nga Policia e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme ishte formuar një grup punues të cilët punuan për projektin e sistemit të ri të pagave sipas Ligjit mbi Policinë. Ky grup kishte përgatitur projektin i cili parashihte shtesat dhe beneficionet siq janë të përshkruara edhe në nenin 60 të ligjit për policinë mirëpo nuk dihej ndonjë afat se kur do të fillonte të realizohej.

Ky grup kishte vërejtur se Policia e Kosovës ka një sistem të pagave i cili nuk merr për bazë shtesat për punët dhe veprimtaritë e policisë të cilat janë specifike vetëm për personelin policor, prandaj konsiderohet se ka

një motivim të ulët për të punësuarit në polici sidomos në pjesën e uniformuar.

Çështja e sigurisë është çështje krciale për Kosovën. Prandaj, ndërtimi i një Policie efektive dhe efikase, të pakorruptuar dhe profesionale ishte i pamundur me një sistem aktual të të ardhurave apo shpërblimeve për zyrtarë policor. Ishte e domosdoshme që të ndryshohej ky sistem në favor të përmirësimit të mirëqenies së personelit policor.

Sistemi aktual i pagave nuk merrte për bazë përvojën e punës, shtesat, rëndësinë apo përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi që ka secili vend pune ose pozitë.

Sistemi i pagave, sidomos ai për zyrtarë policor, duhet të merr në konsideratë disa lloje të shtesave si punën me ndërrime, punën jashtë orarit, punën gjatë ditëve të festave dhe ditëve tjera të pushimit, përgjegjësinë që kanë disa pozita në kuadër të strukturës policore, ekspertiza që kërkohet në njësi të caktuara, rrezikshmëria në të cilën punojnë zyrtarët policor etj.

Policia e Kosovës vazhdimisht synon t'i plotëson standardet që kërkohen për një polici moderne andaj, edhe përmes këtij projekti pretendohet ndërtimi i një sistemi të ri të pagave që të mundësoj funksionim e rregullt të organizatës sepse sistemi ekzis-

tues nuk përkonte as për se afërmi me detyrat dhe obligimet që kanë zyrtarët policorë, sidomos disa specifike të njësive të ndryshme. Një prej qëllimeve të projektit ishte që të krijohen standarde pune për kryerjen e detyrave, përgjegjësi dhe autorizimeve nën kushtet të veçanta për të gjithë zyrtarët policorë.

Në një komunikatë të lëshuar nga Sindikata e Policisë së Kosovës janë dhënë shpjegime për angazhimet e tyre prej themelimit të tyre e deri te formimi i Këshillit Organizativ të Protestave. "Sindikata e Policisë së Kosovës qysh nga themelimi i saj pat identifikuar çështjet prioritare që kërkojnë zgjidhje, e që ishin dhe janë jetike për pjesëtarët e Policisë. Vazhdimisht i shtroi ato si kërkesa urgjente për zgjidhje që nga fundi i vitit 2005 e deri më tash. Në mungesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ligjit të Policisë, Sindikata gjithë veprimtarinë e vet e zhvilloi në rrethana specifike, në mungesë të partneritetit. Me krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Sindikata filloi kontaktet permanente me Ministrinë dhe kërkesat i orientonte për bisedë dhe zgjidhje në drejtim të

kësaj Ministrie.

Kësisoj, Sindikata mori pjesë në mënyrë aktive edhe në Grupin e punës për hartimin e Ligjit të Policisë, deri në formën përfundimtare të tij. Një pjesë e madhe e propozimeve të Sindikatës u morën në konsideratë dhe janë inkorporuar në Ligjin e Policisë e një ndër to është edhe e drejta e protestës.

Që nga aprovimi i Ligjit të Policisë, Sindikata kërkonte zbatimin e tij në tërësi, që nënkuptonte edhe beneficionet (shtesat) e përshkruara në Nenin 60. të Ligjit të Policisë. Nismën e Ministrisë së Punëve të Brendshme që në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të hartojnë Projektin për Sistemin e ri të pagave në Policinë e Kosovës, Sindikata e mirëpriti dhe i dha mbështetje të fuqishme. Si fryt i angazhimit të MPB-së dhe PK-së doli Projekti i Sistemit të ri të pagave në Policinë e Kosovës, të cilin Sindikata e mbështeti dhe kërkoi të filloj menjëherë të implementohet në tërësi. Pakënaqësitë për pozitën e rëndë materiale nga ana e anëtarësisë filluan të shtohen, veçmas pas aprovimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit të Policisë,

veçmas për beneficionet e parapara me Nenin 60. të Ligjit të Policisë Pakënaqësitë veçmas filluan të shtohen me rritjen e pagave për vetëm një sektor (sektorin e arsimit), edhe pse nuk kishte kundërshti pse kjo ndodhi, por kërkonin që kjo të ndodh edhe për Policinë e Kosovës. E ndodhur në këto rrethana, Sindikata u përpoq që përmes kontakteve me MPB-në të arrinte rezultate që sa më parë të fillonte implementimi i Projektit të Sistemit të ri të pagave në Policinë e Kosovës. Kërkesat e Sindikatës të Policisë së Kosovës askush deri më tash nuk i kontestoi, përkundrazi ato u mbështetën nga të gjithë si kërkesa legjitime dhe të arsyeshme. Në këtë drejtim edhe MPB vazhdimisht angazhohej për të gjetur zgjidhje për fillimin e implementimit të projektit.

Në këtë drejtim u premtua angazhim që projekti do të fillojë të implementohet në muajin Shtator, mirëpo edhe kjo nuk ndodhi. Nga trysnia e madhe nga anëtarësia, Kryesia Qendrore e SPK-së themeloi Këshillin Organizativ për organizimin e protestës, si mjet i fundit i veprimit sindikal (e drejtë kjo nga Ligji i Policisë së Kosovës), sikur edhe Këshilli caktoi Ekipin Negociator me detyrë që të arrihet Marrëveshje me MPB-në dhe Qeverinë e Kosovës. Sindikata, MPB-ja dhe Qeveria e Kosovës, duke i dhënë prioritet dialogut arritën që të firmosin marrëveshjen dhe për këtë Sindikata falënderon Qeverinë dhe MPB-në për këtë hap pozitiv të bërë pas nëntë viteve. Në shenjë konsiderate për marrëveshjen e arritur u anulua protesta e paraparë për datën 11.10.2008.

Çfarë përmban sistemi i ri i pagave dhe shtesave për Policinë e Kosovës?

Qëllimi i projektit (tani dokumentit) është mbrojtja e dinjitetit të zyrtarëve policorë në mënyrë që t'ju sigurohet një shtesë të të ardhurave për të stimuluar punën e tyre e cila



është e pashpërblyer plotësisht me pagat e tanishme. Shumë zyrtar policorë (përfshirë stafin civil) po japin dorëheqje, nuk parapëlqejnë të punojnë për shkak të diskriminimit në pagë dhe po sigurojnë pozita në institucione tjera ku paga është e nivelit shumë më të lartë.

Policia e Kosovës ka investuar shumë në përgatitjen dhe ngritjen profesionale të kuadrit të saj në fusha të ndryshme përmes trajnimeve si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit, duke shpenzuar materiale si dhe harxhuar kohë. Prandaj humbja e këtij kuadri të kualifikuar, është edhe humbje e madhe në aspektin e kohës, investimeve dhe realizimit me sukses të objektivit të policisë për parandalimin dhe zbulimin e krimit.

Struktura e pagave e propozuar me këtë Projekt është modeluar mbështetur në Ligjin për Policinë e Republikës së Kosovës, dhe me këtë sigurohet ngritja e pagës nga paga bazë, duke përfshirë disa lloje të shtesave për të gjithë zyrtarët policorë, varësisht prej pozitës, përgjegjësi, detyrave dhe autorizimeve policore.

Një prej shtesave është për përvojën e punës me ç'rast për çdo shkallë, paga bazë aktuale rritet prej shkallës 1 deri në 5 me 3% për çdo vit, ndërsa nga shkalla e 6 deri në shkallën 15 me 3% për çdo dy vite.

P.sh. zyrtarët policorë të nivelit operativ pagën bazë aktuale e kanë 250 Euro dhe nëse ka përvojë pune prej shkallës 1 deri 15 paga rritet për çdo vit nga shkalla 1 deri 5 prej 3% dhe nga shkalla 6 deri 15 për çdo dy vite me 3%, ndërsa të shprehura në para shuma nga paga bazë prej 250 Euro mund të ngritët në shumë totale prej 250 deri në 377 euro.

Përparësi e këtij projekti është se zyrtari policor i nivelit operativ me disa vite përvojë pune mund të marr njëjtë ose më shumë se personi që sapo ka filluar në gradën e re Rreshter. Kur një person avancohet në një gradë më të lartë, se sa grada aktuale, ngritja bëhet në shkallën pasuese më të lartë të shkallës së

pagës mbi pagën aktuale, nëse paga e zyrtarit policorë veç është mbi shkallën e parë të gradës së re.

Ky propozim në projekt konsiderohet me i favorshëm për stafin e uniformuar, në krahasim me sistemin aktual të pagave, sepse brenda pagës bazë mund të inkorporohet edhe përvoja e punës dhe shtesat e ndryshme përmes se cilës realizohen mbulimet mes shkalleve të pagave dhe bëhet balancim i drejtë i punës në raport me shpërblimin në të ar-

Personeli policorë duhet të marrë këto shtesa:

1. shtesa për punë me rrezikshmëri,
2. shtesa për punën jashtë orarit,
3. shtesa për orarin e punës me ndërtime,
4. shtesa për ushtrimin e detyrës,
5. shtesa për punën gjatë festave ose ditëve të tjera që janë ditë pushimi,
6. shtesa për caktim për punë të veçanta dhe për shkathtësi të veçanta.

dhurat vjetore. Kjo nxitë nevojën e motivimit të punëtorëve në punë dhe si rrjedhojë pritët të tregojë suksese shumë më të larta në punë në të gjitha veprimtaritë policore.

Shtesat konsiderohen si pjesë integrale e organizimit dhe procesit të punës. Për të përmbush misionin e organizatës punonjësve, duhet ofruar kushte të mira për punë. Paga (rroga) e të punësuarit në bazë të ligjit të Policisë së Republikës së Kosovës përbëhet nga: paga bazë, shtesat, kompensime dhe benificione.

Paga bazë është e njëjtë për të gjithë zyrtarët policorë të cilët kanë nivel

të njëjtë të gradës, ndërsa shtesat llogariten vetëm për kohën, gjatë së cilës punëtori ka punuar në kushtet për të cilat i takon shtesa, shtesa dallon varësisht nga pozita apo vendi i punës që d.m.th dy të punësuar në gradë të njëjtë për shkak të pozitive të ndryshme dhe përgjegjësisë së ndryshme që kanë apo rrezikshmërisë së ndryshme marrin shtesa të ndryshme.

Me qëllim të ofrimit të standardeve minimale për një mirëqenie me të mirë të zyrtarëve policorë, me ligjin për policinë janë përcaktuar disa lloje të shtesave, qëllimi i të cilave është që për zyrtarët policorë të merr parasysh kushtet e veçanta nën të cilat ata i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.

Si shtesë e pagës bazë apo themelore, zyrtarët policorë në mënyrë të ligjshme duhet të marrin lloje të shtesave, kompensime, dhe benificione sikur që marrin të gjitha forcat policore nëpër botë.

Meqë implementimi i një sistemi të tërësishëm i cili do të përfshijë të gjitha që u thanë më lartë është e vështirë në këtë fazë atëherë është e domosdoshme që në këtë fazë të procedohet me shtesat e përcaktuar me Ligjin e Policisë si pjesa më përmbajtësore e kompensimit për zyrtarë policorë dhe e cila nuk paraqet rritje të pagave por, vetëm dhënie të shtesave për punët nën kushte të veçanta në të cilat punojnë zyrtarët policor.

Sipas marrëveshjes së nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ky dokument do të fillojë të zbatuar që nga 1 Janari i 2009-ës, ndërsa pagesa e shumës së shtesave për muajin dhjetor të këtij viti për shkaqe objektive do të paguhet me pagën e janarit 2009. Në marrëveshje është e paraparë se Sindikata e Policisë ruan të drejtën që në rast të mos respektimit të marrëveshjes, të ndërmerr hapa dhe veprime sindikale.

(Sistemin e plotë të pagesës shtesë mund ta gjeni në Intranet)



“SIGURIA NË RRUGË - SHTATOR 2008” fushatë për sigurinë e fëmijëve



Duke u bazuar në nevojën për rritjen e sigurisë në rrugë, kjo fushatë është organizuar me qëllim për të zvogëluar shkallën e numrit të aksidenteve rrugore me theks të veçantë në zvogëlimin e numrit të aksidenteve me këmbësorë.

Qëllimi i kësaj fushatë është që të rritet vëmendja-përqendrimi, tek pjesëmarrësit në komunikacion për rrezikun e asaj që ata e bëjnë, në rrethana kur nuk i përmbahen rregullave dhe shenjave në komunikacion. Periudha më e rrezikshme është në muajin Shtator kur fillon viti shkollor dhe ndër më të rrezikuarit janë kategoria e fëmijëve të cilët shkojnë prej

shtëpisë në shkollë dhe anasjelltas në përcjellje të prindërve apo pa ta.

Në kuadër të këtij projekti që është përgatitur nga drejtoria e Trafikut në bashkëpunim me policinë në komunitet janë paraparë masa preventive për të siguruar që fëmijët të jenë të sigurt gjatë rrugës së tyre për në shkollë dhe për në shtëpi.

Shkollarët e rinj nuk janë aq pjesëmarrës me përvojë në trafik, bile jo aq edhe si këmbësorë pasi që nuk janë të pjekur sa duhet. Vizioni i tyre nuk është i njëjtë me atë që kanë të rriturit. Ata nuk sillen arsyeshëm, kudo që gjinden apo çfarëdo që bëjnë, ata luajnë në çdo vend dhe në çfarëdo kohe.



"Policët e rinjë" të gatshëm për të kontribuar për sigurinë e qytetarëve

Gjatë implementimit të kësaj fushate policët do t'i kërkojnë vozitësit që zhvillojnë shpejtësi tej normave të lejuara aty ku nxënësit janë pranë rrugës apo ata vozitës që nuk ndalen pranë vendkalimeve kur këmbësorët kuptohet se dëshirojnë të kalojnë në vendkalime.

Implementimi i planit do të jetë në të gjitha rrugët e Kosovës, jo vetëm në rrugët kryesore, sidomos aty ku nxënësit e kanë rrugën e tyre të rregullt për të shkuar në shkollë, përreth shkollave dhe afër vendkalimeve përgjatë rrugës për në shkollë.

Ky projekt parasheh që përveç ligjëratave nëpër shkolla, me një grup nxënësish prej 5 deri 10 të të

dilet në teren "udhëkryqe, vendkalime për këmbësor" dhe të praktikohet lëvizja nëpër vende të tilla së bashku me nxënësit.

Në kuadër të implementimit të këtij projekti në Prishtinë, ekipi i Mbrojtësit kishte qenë prezentë në disa prej udhëkryqeve të kryeqytetit kur "policët e rinjë" rregullonin komunikacionin rrugor dhe u tërhoqnin vërejtjen vozitësve për mosrespektim eventual të shenjave të komunikacionit.

"Zotëri, arsyeja e ndaljes është se ju nuk keni ndezur dritat dhe nuk keni vendosur rripin e sigurisë që është obligativ për ju dhe pasagjerët"- këshillonte njëri nga nxënësit drej-





Qytetarët mirëpresin këshillat dhe vërejtjet nga "policët e rinjë"

tuesin e ndalur nga i njëjti. Fëmijët bartnin me krenari uniformën e policisë vendore dhe shikonin me vëmendje për të gjitha veturat dhe këmbësorët që mos t'ju kalonte ndonjë kundërvajtës pa ju tërhequr vërejtja së paku.

Kjo është një metodë e mirë për ngritjen e vetëdijes së fëmijëve por edhe të pjesëmarrësve tjerë në komunikacionin rrugor - të rriturve.

"Qëllimi ynë është që të rritet vëmendja, përqendrimi tek pjesëmar-

rësit në komunikacion për rrezikun e asaj që ata bëjnë në rrethana kur nuk i përmbahen rregullave dhe shenjave në komunikacion."- theksoi kapiten Jeton Rexhepi nga Trejtoria e Trafikut në DPP.

Ai më tutje ceku se Drejtoria e Trafikut dhe Policia në Bashkësi do të jenë prezent gjatë këtyre ditëve nëpër shkollat ku do të fillon mbajtja e ligjëratave dhe demonstrimet praktike në rrugë për nxënës të këtyre shkollave.



Kapiten Jeton Rexhepi, jep këshilla për qytetarë përmes medive

Njësia për Mbrojtje nga Eksplozivët e Policisë së Kosovës, njësia më e kompletuar në rajon

NJME – aty ku gabimi më i vogël kushton me jetë

NjME është njësi e specializuar e cila përbëhet prej 10 pjesëtarëve dhe funksionon në kuadër të Departamentit të Njësive Speciale Policisë së Kosovës.

Ky njësi është përgjegjës për identifikimin, veprimin, asistimin agjencisë për eliminimin e mjeteve të improvizuara eksplozive, për të gjitha llojet e bastisjeve me rrezikshmëri të lartë dhe rrezikshmëri të panjohura si të veturave ashtu edhe të objekteve, identifikimin e mjetit shpërthyes dhe pjesëve përbërëse të tij, përcaktimin e distancave minimale të sigurisë, rastet e reagimit në të gjitha rastet e kërcënimit me bomba dhe hetimin e

vendit të ngjarjes pas shpërthimit si dhe rikonstruktimin e vendit të ngjarjes ku ka ndodhur shpërthimi që merret si provë në vendimet e gjykatave.

Për të qenë më të informuar rreth angazhimit të këtij njësi dhe pajisjeve që posedojnë ata, ekipi i Mbrojtësit intervistoi kapiten Arbnes Ajvazin – udhëheqësin e NJME-së.

Mbrojtësi: Sa janë të shpeshta rastet kur ju duhet të reagoni?

Kapiten Ajvazi: Njësia e NJME-së angazhohet në rastet e bastisjeve me rrezikshmëri të lartë apo rrezikut të panjohur, në rast të kërcënimeve me bombë, si dhe në rastet kur kërkohet asistenca

për Trajtimin e Mjeteve të Improvizuara dhe Ushtarake Eksplozive. Kjo njësi ka ndërhyrë në 113 raste të de-minimit dhe rasteve të tjera vetëm gjatë nëntë muajve të parë të këtij viti. Shumica e këtyre ndërhyrjeve kanë qenë ndërhyrje me rrezikshmëri të lartë për pjesëtarët e kësaj njësi, mirëpo falë profesionalizmit dhe kujdesit të epërës dhe pjesëtarëve të kësaj njësi nuk ka pasur asnjë lëndim në të gjitha rastet që kemi ndërhyrë.

Sa janë të rrezikshme mjetet e improvizuara eksplozive?

Kapiten Ajvazi: Njësia e NJME-së angazhohet në rastet e bastisjeve me

rrezikshmëri të lartë apo rrezikut të panjohur, në rast të kërcënimeve me bombë, si dhe në rastet kur kërkohet asistencë për Trajtimin e Mjeteve të Improvizuara dhe Ushtarake Eksplozive. Materiet eksplozive paraqesin një rrezik shumë të madh për policinë dhe masën e qytetarëve në përgjithësi. Prandaj rastet e lajmërimit të bombave të improvizuara dhe materieve shpërthyes pa ndonjë përjashtim duhet të trajtohen shumë seriozisht.

Mjetet e Improvizuara Eksplozive (MIE) janë armë jo të zakonshme të ndërtuara në mënyrë manuale duke i përdorur sendet për përdorime tjera jo ushtarake MIE, si sende standarde dhe të cilat shumë lehtë mund të modifikohen. MIE mund të jenë „rimodelim“ i pajisjeve ushtarake apo armë të përdorura kundër njerëzve dhe shoqërisë në periudha të ndryshme kohore. MIE mund të përdoren kundër civileve, punëtorëve, refugjatëve, projekteve zhvillimore dhe forcave paqeruajtëse.

Mbrojtësi: Si qëndroni me pajisje duke pasur parasysh nivelin e lartë të rrezikshmërisë që përfshin kryerjen e detyrave të këtij njësiti?

Kapiten Ajvazi: Pajisjet me të cilat punon kjo njësi vlerësohen si më të mirat në tregun botërorë, pajisjet për afrim të bomba dhe robotët që dirigjohen nga larg. Jemi një ndër njësitë më të pajisura në botë me teknologjinë më të



Kapiten Arbnesh Ajvazi

re dhe synojmë që në një të ardhme të afërt të marrim edhe detyra të tjera që janë trajtimi i mjeteve të improvizuara dhe eksplozive në vendin e ngjarjes, marrja direkte dhe neutralizimi i tyre. Psh. Veshja për afrim tek bomba EOD-9, konsiderohet si pajisja më moderne e kohës dhe që shumica e vendeve të rajonit ende nuk e ka.

Mbrojtësi: Natyrisht se për ndërhyrje të tilla nevojiten edhe përgatitje e lartë profesionale, si qëndroni me trajnime?

Kapiten Ajvazi: Pjesëtarët e kësaj njësie të gjithë kanë të kryer trajnimin bazë për trajtim të mjeteve eksplozive që është mbajtur 3 javë me radhë në Poloni, mirëpo për specifikat e kësaj njësie duhen trajnime të vazhdueshme dhe tani planifikojmë një trajnim në Turqi, për „hetime pas shpërthimit“. Me këtë rast shfrytëzoj rastin të falënderoj Departamentin e Trajnimeve, të cilët në vazhdimësi na kanë dalë në ndihmë lidhur me trajnimet e planifikuara duke na siguruar kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e tyre.

Mbrojtësi: A keni bashkëpunim me njësite – institucione tjera?

Kapiten Ajvazi: Kjo njësi ka kaluar procesin e tranzicionit në korrik të këtij viti dhe ka bashkëpunim me KFOR-in dhe me Trupat e Mbrojtjes së Kosovës dhe këta të fundit cilësohen si bashkëpunëtorët më serioz të njësisë. Kemi bashkëpunim shumë të mirë edhe me Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Elektroteknik - Degën e Robotikës, me të cilët kemi pasur edhe një punim shkencor për parimin e përgjithshëm të punës së robotit që është prezantuar në Egjipt dhe është vlerësuar mjaftë





lartë. Planifikojmë edhe bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore - degën Fizikë-Kimi, në lidhje me eksplozivët dhe mënyrën e aktivizimit të tyre.

Mbrojtësi: Sa ju ka ndihmuar përvoja e kolegëve ndërkombëtarë nga misioni i policisë së UNMIK-ut?

Kapiten Ajvazi: NJME ka pasur vazhdimisht policë ndërkombëtar me të cilët ka pasur dhe vazhdon të ketë një bashkëpunim shumë të ngushtë, dhe trajnime të vazhdueshme në të gjitha sferat e profesionale. Gatishmëria e tyre në trajnimin e stafit dhe dhënia e vazhdueshme e këshillave nëpër raste por edhe për zhvillimin e gjithmbarshëm të njësisë duhet çmuar shumë lartë.

Cilat janë planet për të ardhmen?

Kapiten Ajvazi: Ne planifikojmë të nënshkruajmë një Memorandum të Mirëkuptimit me KFOR-in, për marrjen e përgjegjësitë të plotë për neutralizimin e materieve eksplozive artizanale që nuk janë prodhime të rregullta! Fare në fund dëshiroj të theksoj edhe faktin se është nder dhe privilegj të jem komandant i kësaj njësie. Fryma kolektive, gatishmëria për t'u ndalë në ndihmë qytetarëve dhe marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndër njerëzore dhe profesionale janë karakteristikë e kësaj njësie.

Edhe shefi-këshilltari i këtij njësi nga policia e UNMIK-ut – Jason Standard, i cili ka një përvojë pune me mjetet e improvizuara shpërthyes nga misionet e tij në Irak, Afganistan, Kuvajt dhe Katar shpreh fjalë miradije për këtë njësi:

“Menjëherë pasi erdha në Mision të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, iu bashkëngjita NJME-së të PK-së (në atë kohë e njohur si IEDD) në korrik të vitit 2007. Ky njësi ka poseduar trajnime të mira, por ka pasur nevojë për disa pajisje të specializuara shtesë dhe për trajnimet e ndërlidhura me to. Këto pajisje të specializuara janë relativisht të shtrenjta dhe ka qenë vështirë në atë kohë për NJME-në për të përparuar aq shpejtë sa është duhur për shkak të mungesës së këtyre pajisjeve. Duke u ballafaquar me mungesë të pajisjeve unë e kam ndihmuar njësinë rreth trajnimeve profesionale dhe cilësore duke përdorur teknika të ndryshme të IED/EDO-së me ato pajisje që i kanë pasur në dispozicion.” - theksoi Standard në një intervistë të shkurtë për Mbrojtësin. Ai më tutje vazhdoi:

“Gjatë kësaj kohe derisa jam duke punuar me NJME, unë jam dëshmitarë i përkushtimit dhe durimit të tyre, dy gjëra këto të cilat duhet patjetër t'i kenë njerëzit që punojnë me eksplozivë. NJME-ja është kompetente sikurse cilado 'Skuadër e Bombave' që punon në Ballkan, dhe nëse vazhdojnë të punojnë me përkushtimin e tyre në punë, ajo do të jetë në mesin e liderëve botëror në fushën e operacioneve të 'Skuadrës së Bombave'. Qeveria e Kosovës dhe në veçanti



Jason Standard me kolegët e PK-së

Policia e Kosovës janë duke lëvizur në drejtimin e duhur duke e mbështetur Njësinë e Bombave në kuadër të Policisë. Kosova është një rajon aktiv në lidhje me eksplozivët dhe jo vetëm me granata dore dhe mina tokësore që kanë mbetur nga luftërat përgjatë viteve. Është fakt i jetës së kriminelët mund, dhe kanë përdorur mjete të improvizuara shpërthyes për të shkaktuar dëme e lëndime për arsye të ndryshme. Policia e Kosovës, në veçanti NJME, është njësi më e përshtatshme, e pajisur dhe e trajnuar si duhet për t'u marrë me krime që ndërlidhen me eksplozivë.”

Jason Standard në fund theksoi se ky njësi i PK-së do të vazhdojë përpjekjet që qytetarëve të Kosovës t'ju sigurojë mbrojtjen më të mirë nga eksplozivët, dhe nga elementet kriminale që mund të përdoren për t'iu shkaktuar atyre lëndime. Për ta bërë këtë NJME-së i duhet mbështetja e vazhdueshme e MPB-së, Policisë dhe vet qytetarëve.





POLICIA E KOSOVËS

Themel i rëndësishëm

Institucionet kyçe të vendit uruan policinë për punën e bërë gjatë nëntë viteve duke premtuar mirëqenie më të mirë për zyrtarët policorë

Njësitë të ndryshme të PK-së ishin radhitur në Qendrën për Siguri Publike në Vushtrri ditën kur shënohej nëntë vjetori i Policisë së Kosovës. Ata së bashku me shumë zyrtarë të tjerë të PK-së që nuk kishin pasur mundësi për të ardhur aty për shkak të angazhimeve, festonin këtë ngjarje të shënuar për Policinë e Kosovës. Presidenti i vendit, Fatmir Sejdiu, në këtë ceremoni të organizuar e quajti policinë e Kosovës si një nga tregimet e suksesshme të funksionimit të institucioneve vendore: "Puna dhe zhvillimi i mëtejshmë i Policisë së Kosovës do të jetë një nga themelet më të rëndësishme të së ardhmes së Kosovës, e cila synon

që me kohë të bëhet anëtare me të drejta të plota e BE-së, NATO-s dhe e OKB-së" – theksoi z.Sejdiu në këtë ceremoni.

Ai ishte shprehur para oficerëve të rreshtuar se personalisht do të angazhohet për një mirëqenie sa më të mirë për ta:

"Mirëqenia materiale dhe perfeksionimi i mëtejshmë i mjeteve të punës së policëve tani është zotim i yni i përhershëm ndaj ju them me përgjegjësi se si President i vendit do të angazhohem personalisht që policia jonë të ketë trajtimin më të mirë të mundshëm në kuadër të sistemit institucional të Kosovës".

Kryeministri Thaqi ceku se udhëheqësit e Kosovës "ndihen kre-

nar për arritjet domethënëse të policisë sonë dhe ndihemi edhe më shumë të obliguar që ta vazhdojmë përkushtimin tonë të mbështetjes institucionale për policinë e vendit. Pas nëntë vjetësh rezultatet e punës së policisë janë inkurajuese dhe sukseset që mund të renditen tani këtu janë të shumta."

Edhe ministri i PB-së Pajaziti ishte nderuar që në këtë përvjetor i ishte dhënë rasti ta vlerësoj lart angazhimin e djemve dhe vajzave, epro-rëve dhe zyrtarëve të policisë.

"Ky është një angazhim vetëmohues në kryerjen e misionit për sigurimin e sundimit të ligjit dhe mbajtjen e rendit publik në Republikën e Kosovës. Angazhim për sigurinë e



PAS NËNTË VITEVE i së ardhmes së Kosovës

qytetareve; jetës dhe pronës së tyre. Angazhim për sigurinë e lirisë tonë. Ky vit historik për vendin tonë është shënuar edhe me angazhimin e pashoq në menaxhimin e situatës së sigurisë gjatë procesit të pavarësim-it të vendit, ku ju të dashur pjesëtarë të Policisë së Kosovës treguat nivel të lartë profesionalizmi. Pa dyshim se të gjitha të arriturat e Policisë së Kosovës do të ishin të pamundura pa mbështetjen e vazhdueshme të mekanizmave ndërkombëtarë si: KFOR-in, UNMIK-un, EULEX-in etj, me të cilët ndajmë vizionin e për-bashkët të një Policie Profesionale që u shërben të gjithë qytetarëve të vendit pa dallim"- theksoi ndër të tjera ministri i Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti.

Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti duke falënderuar oficerët e pranishëm për angazhimet e tyre vuri në pah edhe sakrificat nëpër të cilat ka kaluar Policia e Kosovës nëpër vite:

"Të nderuar të pranishëm profesioni i policit është një profesion fisnik dhe bujar por edhe i sakrificës për çka tregon se në mesin tonë në

festimin e këtij përvjetori fiziki-sht na mungojnë shumë djem e vajza pjesëtarët më të devotshëm të shërbimit të cilët u flijuan në mbrojtje të rendit dhe qetësisë, zbatimit të ligjit dhe krijimit të sigurisë për qytetarët. Policia e Kosovës në këtë rrugëtim jo të lehtë ka kuptuar se ky ishte çmimi i demokracisë i rendit dhe qetësisë."- theksoi z.Ahmeti.

Edhe UD. i Komisarit të Policisë z.Frigaard në këtë ditë të shënuar ndihej krenar me të arriturat e PK-së duke pasur parasysh se këtë rrugëtim nëntë vjeçar e kemi bërë së bashku me Policinë e UNMIK-ut duke ndarë së bashku sfidat por edhe sakrificat:

"Duhet të krenoheni me këtë ditë dhe me përparimin që keni bërë, por kujtoni se vendimet që i merrni çdo ditë si polic të PK-ës, kane një ndikim në familjet tuaja, miqtë tuaj dhe shtetin tuaj. Sigurohuni që vendimet të cilat i merrni të jenë ato për të cilat do të vazhdoni të krenoheni."- theksoi z. Frigaard.

Në këtë ceremoni përveç tjerash u ndanë edhe medalje dhe mirën-



johje për oficerët e dalluar të PK-së që u veçuan me sukseset e treguara në aksione të ndryshme policore dhe në punë.





Pamje nga trajnimet e zjarrfikësve në teren



QKSPEZH - trajnime cilësore dhe profesionale

Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), vazhdon të ofrojë dhe të sigurojë cilësi të lartë profesionale gjatë trajnimeve, në menaxhimin institucional si dhe ndarjen e resurseve për të gjitha agjensionet e sigurisë publike. QKSPEZH brenda vitit trajnon rreth 12 mijë zyrtarë të sigurisë publike, me ç'rast çelësi i suksesit të

Qendra për Siguri Publike vazhdon të zbatojë misionin e saj duke përkrahur trajnimet për Agjensionet e Sigurisë Publike

trajnimeve pasqyrohet në bashkëpunimin e ndërsjellë që kanë agjensionet e sigurisë publike.

Bazuar në kërkesat e shumta që i parashtrihen Shërbimit Zjarrfikës të Shpëtimit (SHZSH), për ndihmë në shpëtim të jetës së personave të fundosur, për shuarje të zjarreve, për evakuimet nga ndërtesat e larta, shuarjen e zjarreve malore, nxjerrjen e personave të ngjuar në objekte si dhe dhënien e ndihmës së parë emergjente, Qendra e Trajnimit dhe Edukimit (QTE) të SHZSH-së, e cila funksionon në kuadër të QKSPEZH, organizoi trajnimin e avancuar për zjarrfikje dhe shpëtim, mirëpo kësaj radhe me një pjesë praktike shtesë për shpëtim nën ujë dhe zhytje.

Duke pasur parasysh se një ndër përgjegjësitë e Shërbimit Zjarrfikës është edhe shpëtimi nën ujë, për herë të parë një pjesë nga praktika e trajnimit u mbajt në Liqenin e Batllavës, ndërsa pjesa tjetër në poligonin e Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, në fshatin Bajskë, të Vushtrrisë.





Shefi i Operativës pranë Qendrës për Siguri Publike, Bylent Ribari, tha: " Bazuar në përgjegjësitë e Qendrës për sigurimin e stadarëve profesionale për edukim dhe zhvillim si dhe përkrahjen teknike e administrative, për pjesëtarët e agjensioneve të sigurisë publike, ne vazhdojmë të përkrahim edhe Shërbimi Zjarrëfikës, të cilët pjesën teorike të trajnimit e mbajnë në Qendër, ku dhe kandidatët pajisen me mjete adekuate".

Ky trajnim zhvillohet me asistencë të Shërbimit Zjarrëfikës nga Gjakova dhe me ndihmën e Policisë së Kosovës.

Trajnimin e ndjekin 16 pjesëmarrës të cilët do të jenë në gjendje gadihmërie 24 orë, për raste shpëtimi si të fundosjes në ujë ashtu edhe në raste të shpërthimit të zjarrit.

Kryesuesi i QTE-së, Rahman Sefedini, tha: " rëndësia e këtij trajnimi konsiston në ngritjen e kuadrove në pjesën operative, për një punë

sa më profesionale dhe ndërhyrje më të shpejtë në realizimin e operacioneve".

Ai tha se duke pasur parasysh çdo ditë e më shumë ballafaqimin me zjarre në ndërtesa të larta si dhe rastet që kanë të bëjnë me personat e fundosur në ujë, janë organizuar këto trajnime me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë për qytetarët e Kosovës.

Në kuadër të trajnimit realizohen një mori testimesh: testimet e aftësive fizike, testimet e frikës në lartësi deri 23 metra, testimet për përdorimin e aparateve të frymarjes si dhe pjesa teorike e testeve që zhvillohet në Qendër.

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës

Trajnimet e tilla, me përfundim të suksesshëm, arrijnë të mbahen falë bashkëpunimit me agjensio-net tjera të sigurisë publike, e në

veçanti bashkëpunimit me policinë e vendit.

Ndërkaq, me ndihmën e Policisë së Kosovës bëhet sigurimi i vendit të ngjarjes dhe gjetja e dëshmive të shkaktarit të zjarrit.

Drejtori i Drejtoratit të trajnimeve mandatore, Nënkolonel Driton Zabërgja, rreth bashkëpunimit polici-zjarrëfikës, tha: " Policia e Kosovës si detyrë prioritare ka mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së njerëzve, prandaj duke u bazuar në qëllimin e njejtë që kanë policia dhe zjarrfikësit, bashkëpunimi reciprok nuk do të mungojë as në të ardhmen, duke llogaritur mbatjen e trajnimeve të ndryshme në Qendër, përfshirë edhe pjesën praktike sipas nevojës".

Ai ceku se PK-ja do t'i përkrahë sa herë që është e nevojshme njësitet e shërbimeve zjarrfikëse në kryerjen e detyrave zyrtare.

Njomza Krasniqi
Zyrtare e Lartë për Media





Kosova dhe Shqipëria - partnerë të rëndësishëm në fushën e sigurisë në rajonin e Ballkanit

Së bashku në luftën kundër krimit të organizuar

Krimi, e sidomos ai i organizuar nuk njeh kufij. Këtë thënie e kemi dëgjuar shumë herë e tani edhe jemi duke e "prekur" në kuadër të intensifikimeve të Policisë së Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar. Mirëpo sukseset në luftimin e këtij lloji të krimit varen shumë edhe nga bashkëpunimi me policitë e vendeve të rajonit dhe më gjerë. Deri tani PK-ja ka pasur disa aksione të suksesshme në disa aksione të përbashkëta me policitë e rajonit si asaj të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Në këtë aspekt do të ndihmon-te shumë edhe integrimi i Policisë së Kosovës në strukturat ndërkombëtare policore si Interpol-i, Europol-i, SECI-qendra etj e që kjo mbetet një nga synimet kyqe të PK-së për të ardhmen e afërt.

Në kuadër të bashkëpunimit të policive në këtë fushë, më 25 shtator të këtij viti u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e sigurisë në mes MPB-së së Kosovës dhe asaj së Shqipërisë. Ministri i PB-së së

Shqipërisë që kishte ardhur për një vizitë në Kosovë dhe për të nënshkruar këtë marrëveshje tha se shteti shqiptar me pavarësimin e Kosovës tani ka edhe një partner shumë të rëndësishëm në fushën e sigurisë: "Tani ne kemi një partner serioz në përpjekjet e të gjitha instrumenteve dhe të gjitha institucioneve të zbatimit të ligjit të të gjitha vendeve të rajonit në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar"- theksoi ministri i PB-së së Shqipërisë – z.Bujar Nishani. Ai gjatë qëndrimit të tij në Kosovë vizitoi edhe Policinë e Kosovës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë.

Operacioni "Alberta" vë në pranga 12 persona për trafik armësh

Në vijim të luftës kundër krimit të Organizuar dhe atij trans-kufitar dhe bashkëpunimit në mes Policisë së

Shqipërisë dhe Policisë së Kosovës u finalizua operacioni i koduar "ALBERTA".

Ky operacion që ishte realizuar në bashkëpunim në mes dy policive, kishte për qëllim luftimin e krimit të organizuar – trafikun e armëve dhe municionit. Një dërgesë e kontrolluar e armëve Kosovë - Shqipëri për të cilën policia e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë kishte informata bëri të mundshëm arrestimin e 5 shtetasve të Shqipërisë nga Policia e Tiranës më 20.09.2008.

Në ndërkohë operacioni "ALBERTA" kishte filluar së implementuari edhe në Republikën e Kosovës. Më 21.09.2008, rreth orës 15:00 në pikën kufitare Shqipëri-Kosovë të Qafë Morinës policia arrestoi dy persona të dyshimtë meshkuj kosovar për dyshim trafikimi me armë derisa ata ktheheshin nga udhëtimi ku kishin kontrabanduar armatim atje.

Policia e Kosovës me këtë rast konfiskoi nga të dyshimtët rreth 1000 € që dyshohet të jenë paratë e marra nga trafikimi i armëve në Shqipëri si dhe automjetin e tipit Mercedes 124 me targa KS.

Policia kishte filluar bastisjen edhe në disa lokacione të tjera në kuadër të këtij operacioni si në lagjen e Kolovicës dhe atë të Vranjencit në Prishtinë, në Bardhosh, në Podujevë dhe Lipjan me ç'rast u arrestuan edhe pesë persona të dyshimtë.

Gjatë bastisjeve nga hetuesit policor të përkrahur nga Njësi Mbështetës Operativ të Prishtinës konfiskuan në cilësi të dëshmive materiale një sasi të konsiderueshme të municionit (rreth 1500 fishekë të kalibrave të ndryshëm) dhe një sasi të dyshimtë të eksplozivit 500gr që dyshohet të jetë i llojit tritol.

Në një Konferencë për media që ishte organizuar për këtë operacion, Gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti e cilësoi të suksesshëm operacionin "Alberta" falë bash-

këpunimit të mirë me Policinë e Shqipërisë: "Ky operacion që ishte i udhëhequr nga Policia e Kosovës me një bashkëpunim të shkëlqyer me Policinë e Shqipërisë tregon rëndësinë e bashkëpunimit në mes policive të rajonit dhe më gjerë në luftimin e krimit e posaçërisht atij të organizuar"- theksoi Gjeneral nënkolonel Ahmeti duke ftuar policitë e rajonit që së bashku të realizojnë misionin e përbashkët në luftë kundër krimit.

Edhe Gjeneral major Rrahman Sylejmani duke dhënë shpjegime lidhur me operacionin ceku se bashkëpunimi i tillë është mesazh i qartë për policitë e vendeve të rajonit se krimi nuk njeh kufi:

"Qëllimi i operacionit ishte që të arrestohen pjesëtarët e këtij rrjeti të trafikantëve të armëve në Kosovë dhe Shqipëri" – theksoi gjeneral major Sylejmani.

Nënkolonel Fatos Haziri nga Drejtorati kundër Krimit të organizuar të PK-së në këtë konferencë ceku se hetimet lidhur me aktivitetet ilegale të këtij rrjeti kishin filluar në bashkëpunim edhe me Policinë e Shqipërisë qysh nga muaji Gusht i këtij viti:

"Nga procesi i hetimit ne kemi vërtetuar se kemi të bëjmë me një grup kriminal që ka vepruar në Kosovë dhe Shqipëri. Me operacione të tilla ne premtojmë një rend të mirëfilltë juridik si një partner i ri në rajon" – theksoi nënkolonel Haziri.

Në këtë konferencë u cek se ekziston një bashkëpunim i mirë edhe me policitë e vendeve të rajonit si Maqedonia, Mali i Zi dhe më gjerë.

Ndërsa Zv.Komisari i Policisë së Kosovës – Sheremet Ahmeti kishte pranuar një thirrje telefonike nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shqipërisë – z.Ahmet Prençi nga i cili është përgëzuar për suksesin e arritur gjatë këtij operacioni dhe bashkëpunimin e mirë të dy policive.





Shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë, Yves de Kermabon duke vizituar nënstationin e PK-së në Vitomiricë-Pejë

EULEX - mbështetje për Policinë e Kosovës



Nga: Karin Limdal & Franc Harris

Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë –EULEX, është misioni më i madh civil i ndërmarrë bazuar në Politikën Evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP). Synimi kryesor i misionit është mbështetja e autoriteteve të Kosovës përmes monitorimit, përkujdesjes dhe këshillimit në të gjitha fushat që lidhen me sundimin e ligjit, në veçanti me policinë, drejtësinë dhe doganat. Në të njëjtën kohë, EULEX mban

disa përgjegjësi ekzekutive. Është mision i gjerë teknik i udhëhequr nga Shefi i Misionit Yves de Kermabon, që punon brenda kornizës së Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe me një mandat që rrjedh nga ai që quhet Veprim i Përbashkët i 27 shteteve anëtare të BE-së. EULEX-i mbështet parimin e përgjegjësisë dhe pronësisë lokale vendore. Institucionet e Kosovës janë ato që duhet të jenë në vendin drejtues. EULEX-i është aktualisht në një fazë të ndërtimit dhe nuk është ende operacional. Anëtarë të rinj të misionit po mbërrijnë çdo javë dhe parashikojmë të jemi plotësisht të dislokuar, me përafërsisht 1900 ekspertë ndërkombëtarë dhe 1100 ekspertë lokal, të gatshëm për të marrë përgjegjësi operationale nga fundi i vjeshtës së këtij viti. Komponenti i Policisë në EULEX është pjesë e mbështetjes së

përgjithshme të këtij misioni për autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit. EULEX-i do të ndihmojë Policinë e Kosovës (PK-në) për të punuar në drejtim të policisë shumë-etnike, që është e lirë nga ndërhyrjet politike dhe që i shërben popullit të Kosovës.

EULEX-i synon ta bëjë këtë përmes monitorimit, përkujdesjes dhe këshillimit të PK-së. Kështu që, oficerët e policisë së EULEX-it do të bashkë-vendosen me kolegët e tyre të PK-së në të gjithë Kosovën. Për shkak se ne mbështesim parimin e pronësisë vendore, oficerët e policisë të EULEX-it do të kenë kryesisht një rol mbështetës. Policia e Kosovës e jo ne, do të jenë në udhëheqje të kryerjes së punës policore në Kosovë.

Mandati i EULEX-it i jep gjithashtu misionit mundësinë për të përdorur pushtete korrigjuese. EULEX-it do ti

duhet të ndërhyjë veçanërisht nëse autoritetet e Kosovës dështojnë në parandalimin e dhunës kundër komuniteteve jo-shumicë ose në rast të ndërhyrjes politike që minon sundimin e ligjit. Sidoqoftë, EULEX beson se përdorimi i pushtetit korrigjues do të jetë i nevojshëm vetëm në raste të veçanta.

Komponenti këtij misioni do të ketë në total afër 1.400 oficerë ndërkombëtarë të policisë që parashikohet të dislokohen në tërë Kosovën. Personeli është i strukturuar në përputhje me detyrat e veta respektive në tre departamente: departamenti i Forcimit, i Policisë Ekzekutive dhe ai i Policisë Speciale.

Filozofia bazë që do të drejtojë punën e monitorimit, përkujdesjes dhe këshillimit nga Komponenti i Policisë në EULEX, njihet si Qasje Pragmatike- një metodë e strukturuar dhe sistematike për të ndihmuar policinë e Kosovës për të arritur ndryshim pozitiv. Ajo që është vijëzuar nga Deklarata e Misionit të EULEX-it është një proces reforme: psh. lëvizja e Policisë së Kosovës nga gjendja e tyre aktuale në një gjendje të dëshiruar të qëndrueshmërisë, llogari-dhënies dhe përgjegjësisë, shumë-etnicitetit, lirisë nga ndërhyrjet politike dhe referim në standardet e njohura ndërkombëtarisht dhe praktikrat më të mira evropiane.

Ngjashëm me punën e një dirigjenti të një orkestre të madhe, Zyra e Programeve të EULEX-sit, do të përkthejë temën e gjerë muzikore të dhënë nga Këshilli i BE-së dhe për të cilën është rënë dakord nga Qeveria e Kosovës, në një simfoni koherente.

Kjo do të përfshijë një numër detyrash. Së pari, zhvillimin e notave

muzikore në hollësi për pjesë të ndryshme të orkestrës së EULEX-sit, (psh. ekspertët e EULEX për policinë). Së dyti, për tu siguruar që secila pjesë e kësaj orkestre është e njohur me notat e veta muzikore dhe ka mundësi që të luajë instrumentet e veta (psh. secili ekspert i EULEX-it duhet të jetë i njohur me detyrat e Programit të EULEX-sit, ligjet në zbatim dhe politikat dhe procedurat relevante. Së treti, do të kërkojë një sistem rigoroz të komunikimit të informacionit midis dirigjentit dhe pjesëve të orkestrës (psh. një Zyre Programi efektive, që ka mundësi të bashkërendojë aktivitetet e Programit dhe Informimit). Së fundi, për secilën fazë të procesit do të duhet të bihet dakord me homologët e EULEX-it në sundimin e ligjit në Kosovë, në këtë rast me Policinë e Kosovës dhe duhet ti komunikohet akterëve të tjerë ndërkombëtarë.

Qasja Pragmatike e EULEX-it është në zemër të punës që duhet të bëhet nga vëzhguesit dhe këshilltarët e Komponentit të Policisë në EULEX dhe do të përdoret për të matur përmirësimet dhe zhvillimet brenda Policisë së Kosovës dhe institucioneve të lidhura me Policinë e Kosovës. Stafit të EULEX-it që do të bashkë-vendoset me kolegët e vet vendorë, do ti bëhet një seri pyetjesh specifike çdo muaj lidhur me zhvillimet në fushat ku ata janë specialistë. Përgjigjet për ato pyetje do të tregojnë me kalimin e kohës, sesi po kryen detyrat Policia e Kosovës, do të japin shenjat e forcave dhe dobësive të saj. Në varësi të këtyre rezultateve, mund të bëhen ndryshime për të përmirësuar performancën dhe cilësinë në Policinë



Shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë-Yves de Kermabon

e Kosovës.

Qasja Programatike e EULEX-sit mund të shihet si një cikël në zhvillim i vlerësimit të performancës, identifikimit dhe diagnozës së dobësive, strategjive shëruese për të cilat është rënë dakord bashkërisht, zbatimit dhe vlerësimit të përmirësimit në performancë. Rishikimet periodike do të lejojnë palët relevante që të vlerësojnë përparimin e arritur, të formulojnë ose ri-formulojnë strategjitë shëruese dhe të marrin vendime për politikrat që do të ndiqen për përqendrimin e saktë të përpjekjes. Secili rishikim shkrehet nga një raport gjithë-përfshirës i Zyrës Programuese të EULEX-sit që jep konkluzione të përmbledhura bazuar në të dhënat e mbledhura në kohë, si dhe rekomandime që lidhen qartë me konkluzionet. Këto raporte do të frymëzojnë diskutime lidhur me natyrën dhe shkaqet e performancës së dobët dhe do të rezultojnë në vendime lidhur me mënyrat me të cilat Policia e Kosovës, më shumë se EULEX-si në Ko-



Gjeneral Nënkolonel Sheremet Ahmeti gjatë diskutimeve me stafin e tij dhe atë të EULEX-it

sovë, do të bien dakord dhe do të veprojnë për zgjidhjet më efektive.

Kjo ka të bëjë me një marrëveshje për një politikë të përbashkët, por është Policia e Kosovës ajo që do të zbatojë ndryshimet. EULEX-i nuk do

ta bëjë këtë për Policinë e Kosovës. EULEX-i thjeshtë ofron një mjet ekskluziv, të përdorur ndonjëherë më parë në një shkallë të tillë, në një mision të ESDP-së, përmes të cilit Policia e Kosovës do të ketë mundësi të vlerësojë performancat

e veta dhe të marrë vendime se në cilin drejtim dëshiron ta çojë Policinë e Kosovës.

Gjithçka është në duart tuaja.

Për më shumë informacione, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të EULEX-it www.eulex-kosovo.eu



Shefi i misionit të EULEX-it - Yves de Kermabon dhe Ministri Pajaziti së bashku me stafin e QKSPEZH-it gjatë vizitës në Vushtrri



Familjarët e policëve të rënë në detyrë të pritur nga MPB-ja dhe Sindikata e PK-së

ATA NUK HARROHEN KURRË

“Sa herë shohim policë të Kosovës duke u përballur me krimin, na kujtohen pjesëtarët e Policisë së Kosovës që nuk janë më”, ministri Pajaziti

Në prag të festës së Bajramit, Ministri i Punëve të Brendshme, z. Zenun Pajaziti dhe përfaqësuesi i Sindikatës së Pavarur të Policisë së Kosovës, z. Shaban Tasholli pritën familjarët e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të rënë në detyrë.

Pasi i përshëndeti familjarët e policëve të rënë në detyrë, ministri i Punëve të Brendshme, z. Zenun Pajaziti theksoi se “po mundohemi që të jemi sa më të kujdesshëm dhe sa më afër Juve. Ju duhet të jeni krenarë, sepse familjarët tuaj janë heronj të rënë në detyrë”.

Duke folur për përkushtimin e institucioneve të Kosovës e në veçanti të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ministri Pajaziti theksoi se “përkushtimi i MPB-së dhe i Policisë për këto familje nuk do të mungojë asnjëherë.

“Sa herë shohim zyrtarët e Policisë së Kosovës duke u përballur me krimin, na kujtohen pjesëtarët e Policisë së Kosovës që nuk janë më”, theksoi ndër të tjera ministri Pajaziti.

Shaban Tasholli, Zv. Kryetar i Sindikatës së PK-së pasi i përshëndeti të pranishmit, theksoi se Ministria e Punëve të Brendshme i ka ndarë nga një shumë në vlerë prej 500 euro për secilën familje të policëve të rënë në detyrë, ndërsa Sindikata e Pavarur e Policisë së Kosovës e ka ndarë po ashtu një shumë në vlerë prej 100 eurosh, ndërkohë që familjarëve ua shpërndau mjetet e MPB-së dhe të Sindikatës të Policisë së Kosovës.

Po ashtu z. Tasholli i njoftoi të pranishmit se OJQ “Au-

reola” nga Prishtina i ka ndarë 5 bursa për fëmijët e policëve të rënë në detyrë, përkatësisht katër bursa për nxënës dhe një bursë për student. Familjarët e policëve të rënë në detyrë i nënshkruan bursat njëveçare para përfaqësueses së OJQ “Aureola”.

Ky nuk ishte organizimi i vetëm që ishte bërë për të ndihmuar familjet e oficerëve të rënë në linjë të detyrës. Një ditë para se policia të festonte nëntë vjetorin e themelimit, më 5 shator 2008, në stadiumin e futbollit në Prishtinë, policia organizoi një ngjarje që përfshiu tri ndeshje futbollit si dhe një koncert me këngëtarë vendor. Aty ishin të ftuara personalitete të ndryshme dhe familjarët e oficerëve të vrarë në linjë të detyrës.

Ndeshjet e futbollit i paraprinë koncertit. Ekipet e futbollit nga Policia e Kosovës, Shërbimit Doganor, Zjarëfikësve, KFOR-it, MSU-së treguan përgatitjen e tyre fizike por në këtë rast duke matur shkathtësitë e tyre në futboll dhe duke krijuar miqësi të reja.

Shumë këngëtarë të estradës kosovare ju përgjigjën ftësës për të marrë pjesë në këtë ngjarje. Ata ndiheshin krenarë për këtë kontribut të tyre për policinë vendore: “Natyrisht ne këngëtarët mundohemi të jemi pjesë e kontributit për cilindo institucion vendor e posaçërisht për Policinë e Kosovës. Ata përkujdesen për sigurinë tonë e ne mundohemi që me anë të këngës të japim një kontribut për policinë vendore” – theksoi Adelina Thaqi pas debutimit të këngës së saj në këtë koncert.



Komisari Frigaard i dorëzon çekun Sheremet Ahmetit

Edhe Besnik Qaka nga grupi NRG Band ndante mendimin e njëjtë:

"Jam krenar që jam pjesëmarrës në këtë koncert sepse policia është duke bërë një punë shumë të mirë"- theksoi ai. Kjo nuk ishte ngjarja e vetme. Më 28 Gusht në ora 21:00 në restorantin "Duplex" për këtë fond u mbajt një rok koncert nga rok grupi "Kthjellu". Me anë të këtyre ngjarjeve policia tenton të krijojë një fond të veçantë për policët në Kosovë dhe të ndihmohet Sindikata e Policisë së Kosovës. Kjo iniciativë vjen nga policia ndërkombëtare-Luis Cisneros (Zyra për Informim), por është përkrahur nga policia vendore lidhur me organizimin e këtyre ngjarjeve.

Qëllimi i këtij organizimi është që pas grumbullimit të mjeteve financiare, brenda termeve ligjore të Kushtetutës së Republikës së Kos-

ovës dhe Ligjit për Policinë të zhvillohet një fond i veçantë për zyrtarët e Policisë së Kosovës.

Për të bërë këtë ngjarje sa më madhështore dhe për të zgjuar interesimin e qytetarëve patëm edhe përkrahjen mediale nga RTK-ja si televizion publik. Pas përfundimit të tërë organizimit, më 6 shtator, në Qendrën për Siguri Publike në Vushtrri) në nëntë vjetorin e Policisë së Kosovës, Komisarit të policisë ju prezantua çeku me shumën e mjeteve të mbledhura për fondin e veçantë për PK-në.

Policia falënderon për përkrahje të gjithë këngëtarët e estradës (pjesëmarrës në koncert), moderatorët Teuta Krasniqi dhe Fatmir Spahiun, MPB-në, klubin e futbollit "Prishtina", dhe të gjithë të tjerët që kontribuan në organizimin e këtyre ngjarjeve.



Reshat Maliqi dhe Komisar Frigaard shikojnë me interesim ndeshjen e futbollit



Zyrtarët policorë të kënaqur me programin e koncertit



Moderatorët në skenë: Teuta Krasniqi dhe Fatmir Spahi



Bubulina Krasniqi gjatë koncertit



Adelina Thaqi & Visari



Pamje nga shikuesit



Motrat Mustafa



NRG Band

1



Fotot tregojnë pamje nga ceremonia ku Qeveria Amerikane i ka dhuruar Shërbimit Doganor dhe Policisë Kufitare pajisje që do të ndihmojnë në luftimin e krimit dhe të kontrabandës. Në foto shihet Ambasadorja Tina Kaidanow duke shikuar demonstrimin e pajisjeve të reja nga zyrtarët doganor. Vlera e donacionit është mbi 1 milion e 100 mijë dollarë Amerikan.

2



Edhe Teuta Krasniqi, moderatore e koncertit të organizuar nga policia, i ishte gëzuar fitores së shënuar në ndeshjen miqësore të futbollit në mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së UNMIK-ut. Rezultati 11:0 për policinë vendore e bënte "kapitenen" të ndihej krenare për PK-në dhe ekipin e saj të futbollit.

3



Fotoja tregon pamje nga dita kur një pjesë e oficerëve të Divizionit të Sigurimit nënshkruan kontratat e tyre në PK. Ditë më parë Qeveria e Republikës së Kosovës kishte nxjerrë vendimin me të cilin ndryshohet statusi i rreth 570 oficerëve të sigurimit në zyrtarë policor. Këta zyrtarë do të vijojnë trajnimin në QKSPEZH në Vushtri.

4



Fotot lart tregojnë suksesin e PK-së në Pejë dhe sasinë e arit të zbuluar atje. Sipas hetimeve të para dyshohet se në paketimet e zbuluara ka ari të përpunuar dhe të pa përpunuar- rreth 55.5 kg si dhe valutë në 84.000 Euro dhe 2 450 CHF franga zvicerane.



Pamje nga ndeshja e futbollit në mes Policisë së UNMIK-ut dhe Policisë së Kosovës.
Kupa ju dorëzua ekipit më të mirë - atë të Policisë së Kosovës që fitoi me rezultat bindës 11:0.

